



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr.2053/1 prot.

Tiranë, më 02.10.2024

Lënda: Mbi bashkërendimin e një projektvendimi

MINISTRISË SË FINANCAVE

Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 12244 prot., datë 16.09.2024, administruar me tonën me nr. 2053 prot., datë 18.09.2024, përmes së cilës dërgohet për bashkërendim projektvendimi “Për krijimin e regjistrit për kthimin e garancive shtetërore” së bashku me relacionin shpjegues, më poshtë gjeni vlerësimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”).

Nëpërmjet shkresës nr.1786/1 prot., datë 01.08.2024, kemi sugjeruar që Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer (në cilësinë e “Kontrolluesit”) duhet të jetë pjesë e Aneksit I, të Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 463, datë 10.12.2020 “Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin” i ndryshuar.

Ky detyrim buron nga ligji i posaçëm nr. 10129/2009 “Për gjendjen civile” i ndryshuar, dhe legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale, të cilat parashikojnë dispozita konkrete dhe specifike, në kuadër të procesit të përpunimit të të dhënave personale dhe ndërveprimit të databazave me shërbimin e gjendjes civile, të cilat duhen respektuar nga çdo kontrollues.

Ndërkohë, pas analizimit të legjislacionit specifik, në zbatim të të cilit ushtron veprimtarinë kontrolluesi, konkretisht ligjit nr. 55/2023 “Për menaxhimin e garancive dhe kredive shtetërore të pakthyer” vërejmë se, ky i fundit legjitimohet të administrojë dhe të mbledhë informacione dhe të dhëna nga ndërveprimi me baza të tjera të dhënash shtetërore, në kuadër të administrimit të Regjistrit për Kthimin e Garancive Shtetërore.

Gjithashtu konstatojmë se, së fundmi kontrolluesi është pjesë e pikës 1, të Aneksit 1, të Udhëzimit të përbashkët nr. 463, të ndryshuar (*botuar në Fletore Zyrtare nr. 135, datë 02.08.2024*).

Në këto kushte, Zyra e Komisionerit vlerëson se projektvendimi është konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi